



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:215275

Datë: 23.02.2024

Numri i dokumentit: 05554200

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil,gjyqtari Burim Emërllahu ,në çështjen kontestuese të paditësit A.D. ,nga Ferizaj,Rr’’.....,nr.201, kundër te paditurve S.D.,M.D., A.D.,R.D. nga Ferizaji,....’’[ose Fshati Bibaj Komuna e Ferizajit] ,tani me adresë të panjohur të vendbanimit,M.D. nga Ferizaji Rr’.....nr,me numër personaltani me adresë të panjohur të vendbanimit ,S.V. ,nga B..... ,B.B. ,nga ,D.L. ,nga , të cilët i përfaqëson në cilësi të përfaqësuesit të përkohshëm avokati Behar Sejda ,nga Ferizaji,J.D. nga Fshati Komuna ebashkëshorte e A.D. e ky i fundi A.D. me numër personalL.D. nga fshati tani me adresë të panjohur të vendbanimit, të cilin e përfaqëson në cilësi të përfaqësuesit të përkohshëm avokati Behar Sejda ,nga Ferizaji, M.D.,G.D. ,me numër personal ,F.D.,D.D., B.D., nga Fshati Komuna e V.... ,Z.D.[bashkeshorte e D.D. e ky i fundit –D.D. me numer personalA.D.j,me adresë të panjohur të vebndbanimit të cilët i përfaqëson në cilësi të përfaqësuesit të përkohshëm avokati Behar Sejda ,nga Ferizaji,K.D. [sipas certifikates K.D. jeton ne] me vendbanim në Ferizaj Rr..... juridike vërtetim i pronësis dhe anulimi i kontratës me datën 23.02.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I.Refuzohet si e pa bazuar pjesa e kërkesëpadisë së paditësit A.D. ,me të cilën ka kërkuar që të anulohen :Kontrata me nr.7189/11 e vërtetuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj, me datë 12.09.2011,Kontrata me numër Ve..... e vërtetuar në Gjykatën Komunale të Beogradit ,me datë 29.06.2006, Kontrata me numër e vërtetuar në Gjykatën Komunale të Novi Sadit, me datë 03.10.2006,Kontrata (deklarata) Ve.nr.... të B.B., S.V. e të D.L. vërtetuar pranë Gjykatës së Parë Komunale në Beograd me datë 04.08.2006.

I-1.Hedhet poshtë si e pa lejuar,pjesa e padisë së paditësit A.D. me të cilën ka kërkuar, që sipërfaqja prejm/2, pjesë e ngastrës kadastrale ..., me numër të propozuar nga eksperti gjeodet ZK Ferizaj, të regjistrohet në emër të paditësit A.D., në librin kadastral me qëllim që të bëhet bartja te pronarit faktik,kurse sipërfaqja prej prej 2628 m2 ,pjesë e ngastrës kadastrale ,me numër të propozuar nga eksperti gjeodet ... Zona Kadastrale në Ferizaj ka këto kufijë dhe përmasa:në anën veriore në gjatësi prej 9.39 m kufizohet me pjesën e parcelës ... ZK Ferizaj.Në anën lindore në gjatësi prej 4.58 m kufizohet me parcelën ... ,në gjatësi prej 149.07 m kufizohet me parcelën ... ,në gjatësi prej 110.31 m ,kufizohet me parcelën ... dhe në gjatësi prej 43.46 m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj.Në anën jugore në gjatësi prej 8.10 m kufizohet me rrugën publike dhe në anën perëndimore në gjatësi prej 307.68 m kufizohet me pjesën e parcelës ... ZK Ferizaj.

I-2.Hedhet poshtë si e pa lejuar, pjesa e padisë e paditësit A.D., me të cilën ka kërkuar, që sipërfaqja prej m/2,pjesë e ngastrës kadastrale me numër të propozuar nga eksperti gjeodet ZK Ferizaj, të regjistrohet në emër të paditësit A.D. në Drejtorinë për Urbanizëm , Kadastër, kurse Refuzohet pjesa e kërkesë padisë, së paditësit A.D. me të cilën ka kërkuar, që për paluajtshmërinë në fjalë të kompensoj njësoj si ndaj fqiut,kurse sipërfaqja prej 1981 m2 ,pjesë e ngastrës kadastrale ,të cilës eksperti gjeodet ia ka propozuar numrin e ri kadastral ... ZK Ferizaj e cila sipërfaqe prej ... m2 ka këto kufijë dhe përmasa :Në anën veriore në gjatësi prej 21.64 m kufizohet me parcelën ...-8 ,në gjatësi prej 4.01 m kufizohet me parcelën ... ,në gjatësi prej 16.03 m kufizohet me parcelën prejnë gjatësi prej 16.08m kufizohet me parcelën dhe në gjatësi prej 4.01 kufizohet me parcelën prej ... ZK Ferizaj .Në anën lindore në gjatësi prej ... kufizohet me pjesën e parcelës ... ZK Ferizaj .Në anën jugore në gjatësi prej 8.40 kufizohet me rrugën publike dhe në anën perëndimore në gjatësi prej 435.38 m kufizohet me pjesën e parcelës ... dhe në gjatësi prej 1.08 m kufizohet me parcelën ZK Ferizaj.

I-3.Hedhet poshtë si e pa lejuar pjesa e padisë së paditësit A.D., me të cilën ka kërkuar, që sipërfaqja prej ... m/2 pjesë e ngastrës kadastrale ..., me numër të propozuar nga eksperti gjeodet ... ti bashkohet parcelës me numër 115 me sipërfaqe prej ... m/2 bashkë me të 50% ti takoj paditësit A.D. 50% të paditurit - përfaqësuesit K.D. ,kurse sipërfaqja prej ... m2 ,pjesë e ngastrës kadastrale ... së cilës eksperti gjeodet ia ka propozuar numrin e ri ... ZK Ferizaj ka këto kufijë dhe përmasa:Në anën veriore në gjatësi prej 8.03m kufizohet me pjesën e parcelës ... ZK Ferizaj;Në anën lindore në gjatësi prej 73.32m kufizohet me parcelën ... dhe në

gjatësi prej 9.42m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj- Në anën jugore në gjatësi prej 9.39m kufizohet me pjesën e parcelës ZK Ferizaj dhe në anën perendimore në gjatësi prej 79.59m kufizohet me pjesën e parcelës ...ZK Ferizaj.

I-4.Hedhet poshtë si e pa lejuar, pjesa e padisë së paditësit A.D. me të cilën ka kërkuar,që të regjistrohet në emër të paditësit A.D. sipërfaqja prej 900 m² pjesë e ngastrës kadastrale me numër të propozuar nga eksperti gjeodet ... dhe ti bashkohet parcelës me sipërfaqe prej 2014 +900 = 2914.Kurse refuzohet si e pa bazuar, pjesa e kërkesë padisë së paditësit A.D. me të cilën ka kërkuar, që të të kompensohet si ndaj fqiu.Kurse sipërfaqja prej 900 m² ,pjesë e ngastrës kadastrale së cilës eksperti gjeodet ia ka propozuar numrin e ri ZK Ferizaj dhe këto kufi dhe përmasa :Në anën veriore në gjatësi prej 20.00m kufizohet me pjesën e parcelës ... ZK Ferizaj;Në anën lindore në gjatësi prej 47.25m kufizohet me pjesën e parcelës ... ZK Ferizaj;në anën jugore në gjatësi prej 15.65m kufizohet me rrugë publike dhe në anën perendimore në gjatësi prej 45.19 m kufizohet me pjesën e parcelës ZK Ferizaj.

I-5.Hedhet poshtë si e pa lejuar, pjesa e padisë së paditësit A.D. me të cilën ka kërkuar,që sipërfaqja prejm² pjesë e ngastrës kadastrale me numër të propozuar nga eksperti gjeodet ZK Ferizaj, të bartet në emër të paditësit A.D. Kurse sipërfaqja prej m² ,pjesë e ngastrës kadastrale ... së cilës eksperti gjeodet ia ka propozuar numrin e cila sipërfaqe ka këto kufijë dhe përmasa :në anën veriore në gjatësi prej 10.42 m kufizohet me parcelën ZK Ferizaj ,në anën lindore në gjatësi prej 38.82 m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj,në anën jugore në gjatësi prej 16.71 m kufizohet me rrugën publike dhe në anën perëndimore në gjatësi prej 38.01 m kufizohet me pjesën e parcelës ZK Ferizaj .

I-6.Gjykata Themelore në Ferizaj shpallet inkompetente sa i përket pjesës së padis për ngastrën ... dhe hedhet poshtë si e pa lejuar pjesa e padisë së paditësit A.D.me të cilën ka kërkuar,që parcela kadastrale, me sipërfaqe prej ... ZK Ferizaj të regjistrohet në emër të paditësit A.D.

I-7. Gjykata Themelore në Ferizaj shpallet inkompetente sa i përket pjesës së padis për ngastrën ... dhe Hedhet poshtë si e pa lejuar, pjesa e padisë së paditësit A.D. me të cilën ka kërkuar që parcela kadastrale me sipërfaqe prej m² ZK Ferizaj të korrigohet dhe të regjistrohet në librin kadastral në emër të paditësit A.D.

II.Refuzohet si i pa bazuar propozimi i propozuesit A.D. me të cilin ka kërkuar që të caktohet masa e përkohshme për sigurimin e kërkesëpadis me të cilën mas tu ndalohe të paditurve të disponojnë me ngastrën kadastrave nr..... me sipërfaqe ...ha të regjistruar në fletën poseduese nr..... ZK Ferizaj përmes tjetërsimit, ngarkimit, ndërrimit të destinimit kulturës, apo në çfarëdo forme të ndryshimit të gjendjes në teren dhe në librat e së palujtshmërive.

III.Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi A.D. ,me datë 30.04.2012 ,ka parashtruar padi në këtë gjykatë ,kundër të paditurve N.D. ,S.V. ,B.B., dhe D.L. ,me bazë juridike anulimi i kontratës.

Paditësi A,D, në padi në lidhje me qështjen kontestuese ka theksuar:

I padituri i parë në cilësi të blerësit, kurse të paditurit nga i dyti e deri te i katërti, si shitës kanë lidhur dhe e kanë vërtetuar në gjykatë kontratën mbi shitblerjen e palujtshmërisë të shënuar në kontratë, e cila kinse është ekzekutuar deri sa shitësit nga kontrata ishin të mitur apo të lindur 6. vite pas shitblerjes, që do të thotë se me veprim jo të ndërgjegjshëm kanë verifikuar gjendjen e pronësisë në llogari të kinse blerësit, në palujtshmërinë me të cilën nuk kanë mundur të disponojnë.

Rrethanën se kanë ditur për shitblerjen, por prapëseprapë vehtën në procedurë të posaçme e kanë prezantuar si trashëgimtarë, flet vetëm në favor të pandërgjegjës të kinse shitësve, e posaçërisht të blerësit i cili e ka ditur se për këtë palujtshmëri zhillohet kontest tek ajo gjykatë, dhe lënda tani sipas ankesës gjindet në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, në shkallë të dytë, kompetent për të vendosur mbi ankesën, që udhëhiqet nën Ac (Gž) nr.44/10. Në të cilin palë janë paditësi dhe i padituri i parë, si dhe të etj.

Siç deklarojnë edhe kontraktuesit se shitblerja është bërë në vitin 1973, për çka e kanë ditur, nuk ka patur vend për procedurën fiktive trashëgimore a aq më pak për vërtetimin e kontratës mbi të cilën nuk kanë mundur të kenë dijeni në momentin e lidhjes, kurse ka patur mundësi juridike që ajo palujtshmëri të bartet në blerësit real.

Pasi me këtë punë fiktive juridike paditësi është dëmtuar, pasi atij i takon një pjesë e pasurisë, më sakt ngastra kad. .../1 me sipërfaqe 2.54,10.-ha me paraqitjen e padisë propozon që ajo gjykatë me kompetencë lëndore dhe teritorijale, pas mbajtjes së procedurës të administroj provat e propozuara, e sipas nevojës edhe të tjera, dhe të sjell AKTGJYKIM APROVOHET kërkesëpadia e paditësit, dhe ANULOHET kontrata mbi shitblerjen e lidhur ndërmjet të paditurit të parë, si blerës, dhe të paditurit të dytë deri në të paditurin e katërt si shitës. Vërtetohet se paditësi është pronar i ngastrës kad. Nr. .../1 me sipërfaqe 2.54,10.-ha ZK Ferizaj, më saktë e regjistruar në fletën poseduese nr.....Të paditurit janë të detyruar që paditësit t'ia kompensojnë shpenzimet e kontestit aq sa do të jenë në fund të kontesti.

Paditësi A.D. po ashtu me padin fillestare kishte kërkuar masë të përkohshme për sigurimin e kërkesëpadis me të cilën mas tu ndalohej të paditurve të diponojnë me ngastrën kadastrave nr..... me sipërfaqe 2.54,10.-ha të regjistruar në fletën poseduese nr.... ZK Ferizaj përmes tjetërsimit, ngarkimit, ndërrimit të destinimit kulturës, apo në çfarëdo forme të ndryshimit të gjendjes në teren dhe në librat e së palujtshmërive.

Padia e sipër përmendur me date 09.01.2013 iu kishte dërguar në përgjegjje të paditurit N.D. „në Rrugën ‘....’ nr.3...., kurse në fletëkthesën e dërguar shënonte se ju la në shtëpi dera ishte e mbyllur .

Paditësi A.D. ,me parashtrësën e dates 04.07.2022 ,kishte kërkuar vazhdimin e procedurës kontestimore duke theksuar se me padin bazë si të paditur kanë qenë A.D. ,tani i ndjerë ,i cili ka vdekur në vitin 2020 dhe D.D. Tani i ndjerë i cili ka vdekur në vitin 2021 .Trashëgimtarët e të ndjerit A.D. Janë :J.D.-Bashkëshortja ,fëmijët L.D. ,me vendbanim në Z..... ,M.D., G.D., F.D., D.D. dhe B.D. ,të gjithë me vendbanim në S..... Komuna V....

Paditësi A.D. me date 16.01.2018 kishte bërë zgjerimin e padis ashtu që me padi kishte përfshir edhe A.D. ,nga Fshati Komuna dhe D.D. nga Ferizaji Rr’’

Me date 22.06.2017 paditësi ka bërë përmirësimin e padis sa i përket emri të B.B. duke theksuar se duhet të jetë B..... me mbiemër B.

I padituri N.D. ,me date 10.01.2013 kishte parashtruar përgjegjje në padi në të cilën kishte theksuar:

Paditësi A.D. pranë kësaj gjykate ka dorëzuar padinë për anulimin e kontratës së shitblerjes dhe mases siguruese kunder meje si i paditur e cila lende eidentohet me C.nr....

Lidhur me kete padi të paditësit gjyqtari i qështjes më obligoi që të bëjë këtë përgjegjje në padi ,të cilën ia dorëzoj gjykatës para seancës kryesore konform nenit 99 të LPK-së edhe pse thirrjes për séance kryesore e pranova para dy ditësh edhe të njejtën duhet ta pranojë 8 ditë përpara konform Ligjit.

Me përgjegjësi të plotë deklaroj se kjo padi është e pa bazuar ,sepse për këtë qështje nuk kemi të bëjmë me kurrfarë qështje të anulimit të kontratës,kur dihet se i padituri N.D. me vite të tëra është në posedim dhe pronësi të kësaj paluejtshmërie.

Përndryshe i padituri N.D. vet personalishtë e ka nënshkruar dhe vërtetuar Kontratën e Shitblerjes Vr.nr.... ,e dates 12.09.2011 ,ku ishin prezent edhe shitësit tani të paditurit S.V., ,B.B. dhe D.Ll. dhe këtë akt të shitblerjes e kanë bërë me shprehjen e vullnetit të lirë dhe pa presionin nga askush për PK.nr..../1 ,në sipërfaqe prej 2.54.10 ha të evidentuar në fletën poseduese nr..... ZK Ferizaj.

Paditësi A.D. nu ka kurrfarë të drejte në posedim apo pronësi të kësaj paluejtshmërie ,sepse unë i padituri jam në posedim dhe pronësi të sajë të pa penguar nga askush.

Nga këto arsye bëjë këtë përgjegjje në padi dhe propozoj gjykatës që të pranojë këtë përgjegjje në padi dhe gjatë seancës kryesore të aktvendim me të cilin refuzohet kërkesëpadia e paditësit A.D. ,në tërësi si e pa bazuar.

I padituri N.D. me date 11.01.2013,në seancën gjyqësore në lidhje me masën e sigurimit kishte deklaruar :Mbetem në tërësi pranë përgjegjjes në padi nuk kam të bëjë asgjë me paditësin ,me të njejtin e kemi ndarë bashkësinë familjare dhe jemi kusheri të tretë dhe se problemi qëndron në mes të vëllezërve .Unë këtë paluejtshmëri për të cilën kërkohet vërtetimi i

pronësisë e kam në posedim prej 40 vitesh ,që nga blerja ,se kontratën e kam legalizuar në shtator të vitit 2011 .

I padituri G.D. me date 13.12.2022 ka parashtruar përgjegjje në padi në të cilën ka theksuar :Paditësi ka ushtruar padi me evidencë C.nr..... ,me të cilën padi dhe kërkesëpadi të sajë ka kërkuar njohjen e së drejtës së pronësisë në njësinë kadastrale P-.../1 .Lidhur me pretendimet e paditësit si në padi dhe kërkesëpadi ,i padituri G.D. duke përfshirë edhe anëtarët tjerë të familjes së tij :nënë ,motrat dhe vëllezërit e tij ,përndryshe të gjithë trashëgimtarë të të ndjerit A.D. deklarohet si vijon:fillimisht i padituri në tërësi e kundërshton padinë dhe kërkesëpadin e paditësit si të pa bazuar .Me rëndësi të posaqshme vlen të ceket se të paditurit i mungon legjitimiteti pasiv i palës në procedure ,duke përfshirë këtu edhe anëtarët tjerë të familjes nënë,motrat dhe vëllezërit ,meqë të njejtit asnjëherë nuk kanë qenë dhe nuk janë pronarë të njësisë pronës kontestuese .Paditësi me asnjë provë nuk e ka vërtetuar bazueshmërinë e kërkesëpadisë .Paditësi asnjëherë nuk ka qenë blerës i pronës kontestuese,pjesëmarrës,dëshmitarë ,si dhe trashëgimtarë i pronës kontestuese.Kurse të gjitha thënjet e paditësit në padi janë vetëm fontan dëshirash e asesi kërkesa legjitime dhe të bazuara në ndonjë prove konkrete.Prona nga pjesëtarët e komunitetit serb kanë blerë E.D. Q.D. vllëzër të paditësit dhe Kusheriri i tij N.D.

Nga certifikata pronësore e datës 14.09.2011 ,me numër vërtetohet se pronarë i pronës kontestuese ka qenë N.D. nga babai P. ,i cili ka lënë trashëgimtarët djalin M.D.dhe vajzat S.,M., A. dhe R.D.

I popozojmë gjykatës që ta refuzoj padin dhe kërkesëpadisë e paditësit si të pa bazuar.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve avokati Behar Sejda nga Ferizaji në përgjegjje në padi,me date 23.01.2023 ka theksuar:Thëniet e padis dhe kërkesëpadis i kontestojmë në tërësi .Në padi nuk është propozuar asnjë dëshmitarë me të cilët do të bëhet vërtetimi i pronësisë që është objekt kontesti dhe nuk janë propozuar prova tjera .Njëherit paditësi nuk ka ofruar prova as rreth qmimit të shitblerjes.Kjo padi dhe kërkesëpadi është e pa bazuar ,sepse të paditurit S.D.,M.D., A.D., R.D., M.D., A.D.,R.D., A.D., T.D., I padituri N.D. tani i ndjerë ,e kanë blerë të njejtën paluejtshmeri dhe të njejtën të drejtë e kanë regjistruar në regjistrat kadastralë .Nuk mund të kuptohet se me qfarë baze paditësi është duke kërkuar anulimin e

kontratës mbi shitblerjen të lidhur në mes të palëve të paditura .I propozojmë gjykatës që të refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit.

Avokati Miftar Islami në një përgjegjeje me date 03.10.2019 në emër të B.B. e kishte kundërshtuar padin dhe kërkesëpadin e paditësit duke i propozuar të refuzohet si e pa bazuar,por i njejt i më vonë ka heqë dorë nga përfaqësimi.Av. Miftar Islami në emër të B.B. ka deklaruar :është e vërtetë se paluejtshmëria kontestuese në vitin 1973 i është shitur të paditurit të parë N.D. ,me të cilin janë zhvilluar dhe përfunduar të gjitha bisedat e drejtëpërdrejta lidhur me këtë transaksion ,nga i cili e paditura e tretë bashkë me bashkëpronarët tjerë e ka pranuar qmimin kontraktues dhe menjëherë pas kësaj i padituri pare në këtë rast është future në posedim ,mbajtje ,shfrytëzim të paluejtshmërisë kontestuese.Përveq të paditurës në momentin e kontraktimit të shitblerjes kanë qenë prezentë edhe motrat e mija S.V.por ka qenë prezent edhe Z.B.L. e cila ka ndërruar jetë e të cilën e ka trashëguar djali i sajë D.L. në këtë rast i padituri i katërt ashtu që ky person lajmërohet si bashkëpronarë në paluejtshmerin kontestuese vetëm si pasojë se i njejt pas vdekjes së nënës së tij është shpallur trashëgimtarë i vetëm i sajë

Ajo qka duket interesante është fakti se e paditura e tretë dhe motra e sajë ,nëna e të paditurit të katërt si bashkëpronarë në vëllim 1/3 pjesë ideale të këtyre ngastrave deri në vitin ...kanë jetuar në Ferizaj me paditësin A.D. ,janë takuar shpesh ,i cili asnjëherë nuk ka pasur kurrfarë kërkesë apo vërejtje lidhur me paluejtshmerinë lëndore ,të cilat përndryshe si është theksuar më lartë ato ia kanë shitur Z.N.D. duke theksuar se paditësi A.D. personalishtë nuk ka qenë prezentë as në kohën e negociatave e as me rastin e pagesave të qmimit.

Paditësi A.D. me një parashtrësë të dorëzuar në këtë gjykatë me date 09.02,2024 e ka bërë precizimin përfundimtar të kërkesëpadis duke kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia me përmbajtje si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata provat e administruara i ka vlerësuar sipas nenit 8 të LPK-së dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Me leximin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj, me numër C.nr i datës 10.09.2008, gjykata ka vertetuar se me të njejtin aktgjykim ishte vendosur siq vijon: Pjesërisht ishte aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.D. nga Ferizaj, dhe ishte vërtetuar se

paditësi A.D. është pronar i pjesës së ngastrës kadastrale nr....në vendin e quajtur ‘’ ...’’ në sipërfaqe prej .. m/2 e cila shtrihet nga tromejja e ngastrës kadastrale .nr..... dhe rrugës që shkon në mbrendi të parcelës ..., përgjatë rrugës në gjerësi prej 4.22m që shkon në anën veriore në gjatësi prej 42,77m, si dhe pjesës së ngastrës kadastrale .nr..../1 në sipërfaqe Prej ...m/2 e cila shtrihet nga tromejja në mes të ngastrës kadastrale .nr. .../1, ... dhe rrugës që shkonë në mbrendi të ng.kad.nr ... ne gjerësi përgjatë rruges prej 8,82m, dhe vazhdon në pjesën veriore te ng.kad.nr..../1 ne gjatësi prej 304.23, të cilat evidentohen ne f.p.nr ZK Ferizaj, në emër të të paditurëve, në bazë të mbajtjes dhe shfrytëzimit.

Ishte aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses M.D. nga Ferizaj, dhe ishte vërtetuar se paditësja është pronare e pjesës se ng.kad.nr.... ne v.q ‘’ Fusha’’ shtëpi-ndërtesë ne sip.prej 01.42 ari oborr në sip. Prej 05.00 ari dhe arë e kl.3 në sip.prej 16.64 ari, në sip të përgjithshme prej ...m/2 e cila evidentohet ne f.p.nr..... ZK Ferizaj, në emër të paditurve, në bazë të blerjes dhe mbajtjes.

Ishte aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit E.D. nga Ferizaj, dhe ishte vërtetuar se paditësi E.D. është pronar i ng.kad.nr..... ne v.q ‘’’’ arë e kl.3 ne sip.43.95 ari të shënuar ne f.p.nr ZK Ferizaj, në emër të të paditurve, ne bazë te blerjes dhe mbajtjes.

Ishin detyruar të paditurit B.B. ,S.B.,D.L. që paditësve tui pranojnë të drejtën e pronësisë dhe tui lejojnë regjistrimin e të njejtës në librat gjegjës kadastral pranë Drejtorisë për Gjeodezi ,Kadastër dhe Pronësi në Ferizaj ,në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit ,nën kërcënim të përmbarimit.

Ishte refuzuar pjesa e kërkesëpadisë mbi pjesën e aprovuar të paditësit A.D. që ka të bëjë me vërtetimin e të drejtës së bashkëpronësisë në 1/3 pjesë ideale të ngastrës kadastrale nr..... në vendin e quajtur ‘’’’,me kulturë shtëpi-ndërtesë me sipërfaqe prej 01.42 ari,oborr me sipërfaqe prej 05,00 ari dhe arë e klasit 3 në sipërfaqe prej 18.98 ari ,të ngastrës kadastrale ... ,në vendin e quajtur ‘’’’arë e klasit të 3 ,në sipërfaqe prej 02.54,10 ha si dhe në ngastrën kadastrale ... ,në vendin e quajtur ‘’f.’’,me kulturë arë e klasit të 3 në sipërfaqe prej 43,95 ari ,të shënuara në fletën poseduese nr..... ZK Ferizaj ,si e pa bazuar.

Me leximin e aktgjykimit Ac.nr.... ,i datës 17.11.2009 ,i marrur nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë gjykata ka vërtetuar se me këtë aktgjykim është refuzuar si e pa bazuar ankesa e

paditësit A.D. dhe aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Ferizaj C.nr.445/05 ,i datës 10.09.2008 është vërtetuar.

Me leximin e aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, numër Rev.nr.i datës 01.02.2013 gjykata ka vërtetuar se Revizioni i paditesit A.D. i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr. date 17.11.2009, është hudhur si e palejuar.

Me leximin e certifikatës së lindjes në emër të D.L. e datës: 27.09.2011, me numer te references Fer-..., gjykata ka vërtetuar se prindër të tij janë M.L. baba dhe Z.L. nënë dhe i njejti është i lindur me datë 02.04.1979,në Ferizaj.

Me leximin e certifikatës së lindjes në emër të S.B. e datës: 27.09.2011, me numër të referencës Fer-.... gjykata ka vërtetuar se prindër të sajë janë M.B. baba dhe K.B. nënë dhe e njejta është e lindur me date 01.04.1954 ,në Ferizaj.

Me leximin e certifikatës së lindjes në emër të B.B. e dates 27.09.2011, me numër të referencës Fer-.... gjykata ka vërtetuar se prindër të sajë janë M.B. baba dhe K.B.nënë dhe e njejta është e lindur me date 26.08.1956,në Ferizaj.

Me leximin e cartifikatës së vdekjes ,me numër ... ,e dates 30.11.2022 ,gjkata ka vërtetuar se A.D. nga babai P.D. dhe nëna R.D. ,ka vdekur me date ... ,në Gj.... ,ishte i martuar J.D. ,me numër personal

Me leximin e ekstraktit të lindjes ,e dates 30.11.2022 ,me numër E ... lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në ... gjykata ka vërtetuar se F.D. është i lindur me date ... në ,me të njejtën adresë të vendbanimit ,me gjendje martesore i martuar ,nga babai A.D. ,i lindur me date ... në Stubëll e... dhe Nëna J.D. e lindur me date në S.e.. ,me numër personal

Me leximin e ekstraktit të lindjes ,e dates 30.11.2022 ,me numër E lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në ...gjkata ka vërtetuar se B.D. është i lindur me date ... në S. të ... ,me të njejtën adresë të vendbanimit ,me gjendje martesore i martuar ,nga babai A.D.i lindur me date në Stubëll e... dhe Nëna J.D. e lindur me date ... në ..l e Epërme ,me numër personal

Me leximin e ekstraktit të lindjes ,e dates 30.11.2022 ,me numër E lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në ... gjykata ka vërtetuar se G.D. është i lindur me datenë S....l të

Epërme ,me të njejtën adresë të vendbanimit ,me gjendje martesore i martuar ,nga babai A.D. ,i lindur me date në dhe Nëna J.D. e lindur me date në ,me numër personal ...

Me leximin e ekstraktit të lindjes ,e dates 30.11.2022 ,me numër E lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në ... gjykata ka vërtetuar se J.D. është i lindur me date në S....të,me të njejtën adresë të vendbanimit ,me gjendje martesore e ve ,nga babai J.A. ,i lindur në..... të dhe Nëna F.A. e lindur në T...j ,me numër personal

Me leximin e certifikatës së vdekjes ,e dates 29.04.2022 ,e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Ferizaj ,me numër ... ,gykata ka vërtetuar se D.D. ,i lindur me datë ... ,ka vdekur me datë,në Ferizaj ,ishte i lindur nga babai Q.D. dhe nëna M.D.B. ,emri bashkëshortes Z.D.,me numër personal

Me leximin e certifikates së lindjes ,e dates 25.11.2022 ,me numër ...e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Ferizaj-... Epërme gjykata ka vërtetuar se K.D. është i lindur me date ... në Ferizaj ,me të njejtën adresë të vendbanimit ,nga babai D.D. ,i lindur në të Epërme,me date dhe Nëna Z.D. e lindur në Fshatin K.... me datë ... ,me numër personal

Me leximin e certifikatës së lindjes ,e datës ... ,me numër ...e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Ferizaj-..... gjykata ka vërtetuar se Z.N. është i lindur me date në K. ,nga babai P.N. ,i lindur në K.... ,me date dhe Nëna T.N.K. e lindur në me datë në Stubëll e Epërme ,me numër personal

Me leximin e ekstraktit të lindjes ,i datës 25.11.2022 ,me numër Ee lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Ferizaj-... gjykata ka vërtetuar se A.D. është i lindur me datenë ,nga babai D.D. ,i lindur në,me date dhe Nëna Z.D. e lindur në Fshatin K.... me datë ,me numër personal

Me leximin e certifikatës së lindjes ,e datës .. ,me numër ...e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Ferizaj-... gjykata ka vërtetuar se T.D. është i lindur me date në P.... ,nga babai D.D. ,i lindur në,me date dhe Nëna Z.D.S. e lindur në Fshatin..... me datë,me numër personal

Me leximin e certifikatës së vdekjes e dates ... ,gjkata ka vërtetuar se i padituri N.D. ,i lindur me date ... ,në ,ka vdekur me date ... në B. dhe ishte i lindur nga babai P.D. dhe nëna R.D.K. ,me gjendje martesore i ve ,me numër personal

Me leximin e certifikatës së vendbanimit ,e datës e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile G....-Ferizaj,gjkata ka vërtetuar se M.D. është i lindur me date ,në Stubëll e E.... ,nga babai N.D. dhe nëna T.D.

Me leximin e certifikatës së vdekjes e dates 08.11.2022,me nr..... ,e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në ... gjykata ka vërtetuar se A.D. ,nga babai P.D. dhe nëna R.D. ,i martuar me J.D.i lindur me date në ka vdekur me date nëme numër personal

Me leximin e certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluejtshme ,e dates ,e lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale në Ferizaj ,gjkata ka vërtetuar për parcelën kadastrale me numër Zona Kadastrale në Ferizaj në bazë të aktvendimit të trashëgimisë T.nr.....i dates 04.07.2006 ,i Gjykatës Komunale në Novisad –Kontratën për shitblerjen Vr.nr... ,e dates 12.09.2011 e vërtetuar në Gjykatën Komunal në Ferizaj ishin bërë ndërrime kadastrale ,kurse me datën 07.03.2016 e njejta paluejtshmëri evidentohet në emër të T.D. nga babai Z. ,... pjesë ideale,me numër personal,D.D. ,nga babai P. ,me 2/13 pjesë ideale,me numër personal,N.D. ,nga babai P. ,me ... pjesë ideale ,me numër personal

Me leximin e kërimit të thjeshtë për njësin kadastrale rezulton se krijimi i bashkëpronësisë për T.D., D.D. ,për ngastrën kadastrale Zona Kadastrale në Ferizaj ishte bërë edhe duke u bazuar në :Kontratën për Dhurimin e paluejtshmërisë LRP.nr..... dhe Ref.nr..... ,për T.D.,Kontratën për Dhuratën LRP.nr..... dhe Ref.nr..... Noteri Gazmend Heta ,për D.D.,kurse prona ishte e ngarkuar me masë të sigurisë në bazë të aktvendimit C.nr..... ,i dates 11.01.2013 ,i Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Me leximin e certifikatës pronësore të dates ... ,e lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale në Ferizaj ,gjkata ka vërtetuar se ngastratadastraleme sipërfaqe prej ... m2 ...me sipërfaqe prej 1383 m2 ,.... në regjistrin kadastral evidentoheshin në vitin 2011 në emër të N.D.

Me leximin e aktvendimit të dates 11.01.2013 ,i Gjykatës Themelore në Ferizaj ,gjkata ka vërtetuar se me këtë aktvendim ishte aprovuar propozimi i paditësit dhe ishte caktuar masa përkohshme e sigurimit me të cilën masë u ishte ndaluar të paditurve tjetërsimi,ngarkimi

,ndrimi i destinimit dhe kulturës apo qfarëdo forme e ndryshimit të gjendjes në teren dhe në librat e paluejtshmërive për parcelën nr..... ZK Ferizaj.

Me leximin e aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.... ,i datës 21.06.2013 gjykata ka vërtetuar se me këtë aktvendim ishte Hedhur si e palejuar ankesa e të paditurit –kundërshtarit të sigurimit dhe ishte prishur aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.841/12,i dates 14.01.2013 .Kurse çështja i ishte kthyer gjykatës së shkallës së pare ,ashtu që ankesa e të paditurit N.D. nga Ferizaji si kundërshtar i sigurimit ,e paraqitur me date 04.02.2013 ,kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.841/12 ,i dates 14.01.2013 ishte trajtuar si kundërshtim .

Me leximin e aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.671/13 ,i datës 30.09.2013 gjykata ka vërtetuar se me të njejtin aktvendim ishte korrigjuar aktvendimi i sipër përmendur i dates 21.06.2013 ashtu që në vend që të jetë i Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.841/12 ,i dates 14.01.2013,duhet të jetë C.nr.226/12 ,i dates 11.01.2013 Gjykata Themelore në Ferizaj .

Me leximin e aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj –Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civile ,i dates 15.05.2014 ,gykata ka vërtetuar se me këtë aktvendim ishte hedh poshtë si e palejuar padia e paditësit A.D. nga Ferizaj dhe ishte propozimi për caktimin e masës së përkoshme ishte refuzuar .

Me leximin e aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2468/2014 ,i dates 18.07.2014 ,gykata ka vërtetuar se me këtë aktvendim ishte prishur aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.226/12 ,i dates 15.05.2014 dhe çështja i ishte kthyer të njejtës gjykatë në rivendosje.

Me leximin e ekspertizës së dates 04.04.2023 dhe plotësimit të ekspertizës i datës 06.10.2023 dhe 09.04.2024 ,të hartuara nga ekspertja gjeodete F.B.L. dhe dëgjimin e të njejtës eksperte në seancë gjyqësore gjykata ka vërtetuar:

Parcela ... ZK Ferizaj me sipërfaqe ... m2 me kulturë oborr me sipërfaqe prej... m² dhe arë e klasës 3 është pronë private me pronar Z.D. me pjesë të pronës 1/1 dhe ka këto kufijë dhe përmasa : Në anën veriore në gjatësi prej 23.54m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj;Në anën lindore në gjatësi prej 39.84m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj;Në anën jugore në

gjatësi prej ... kufizohet me rrugë publike dhe në anën perendimore në gjatësi prej 42.66m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj.Në parcelën kadastrale nr.... ka të ndërtuar një shtëpi P+1 në pjesën veriore dhe pjesa tjetër është oborr.

Parcela ... ZK Ferizaj me sipërfaqe 205 m² me kulturë rrugë e rendit 1 është pronë private me pronar Z.Q.D. me pjesë të pronës $\frac{1}{2}$ dhe D.Q.D. dhe ka këto kufijë dhe përmasa;Në anën veriore në gjatësi prej 5.13 kufizohet me parcelën ...-16 ZK Ferizaj;-Në anën lindore në gjatësi prej 39.49m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj.-Në anën jugore në gjatësi prej 5.37m kufizohet me rrugë publike dhe Në anën perendimore në gjatësi prej 39.84m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj.Në parcelën ... ZK Ferizaj nuk ka të ndërtuar ndonjë objekt, por është rrugë.

Parcela ... ZK Ferizaj me sipërfaqe 1191 m² me kulturë oborr me sipërfaqe prej 324 m² dhe arë e klasës 1 është pronë private me pronar D.Q.D. me pjesë të pronës 1/1.

Parcela ... ZK Ferizaj me sipërfaqe 25410 m² me kulturë arë e klasë 3 është pronë private me pronar:N.P.D. me pjesë të pronës 7/13,D.Z.D. me pjesë të pronës 4/13 dhe D.P.D. me pjesë të pronës 2/13.

Parcela ... ZK Ferizaj me sipërfaqe 1099 m² me kulturë arë e klasës 3 është pronë private me pronar Gj.E.D. me pjesë të pronës 1/1 dhe ka këto kufijë dhe përmasa :Në anën veriore në gjatësi prej 5.10m kufizohet me parcelën ..., në gjatësi prej 31.65m kufizohet me parcelën ... dhe në gjatësi prej 9.98m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj; Në anën lindore në gjatësi prej 26.22m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj;Në anën jugore në gjatësi prej 47.35m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj dhe;Në anën perendimore në gjatësi prej 21.37m kufizohet me parcelën .. ZK Ferizaj.Në parcelën...ZK Ferizaj ka të ndërtuar një shtëpi P+1 dhe pjesa tjetër është oborr.

Parcela ZK Ferizaj me sipërfaqe 1099 m² me kulturë arë e klasës3 është pronë private me pronar E.E.D. me pjesë të pronës 1/1 dhe ka këto kufijë dhe përmasa :Në anën veriore në gjatësi prej 47.35m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj;Në anën lindore në gjatësi prej 23.94m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj.Në anën jugore në gjatësi prej 46.88m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj dhe;Në anën perendimore në gjatësi prej 10.22m

kufizohet me parcelën ... dhe në gjatësi prej 13.94m kufizohet me parcelën .. ZK Ferizaj.Në parcelën ... ZK Ferizaj nuk ka të ndërtuar ndonjë objekt, por është livadhë.

Parcela ... ZK Ferizaj me sipërfaqe 1099 m² me kulturë arë e klasës 3 është pronë private me pronar I.E.D. me pjese te pronës 1/1. Pas daljes në terren dhe matjeve të bëra konstatohet se parcela ZK Ferizaj kufizohet: Në anën veriore në gjatësi prej 46.88m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj;Në anën lindore në gjatësi prej 24.63m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj;Në anën jugore në gjatësi prej 46.50m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj dhe Në anën perendimore në gjatësi prej 23.68m kufizohet me parcelën .. ZK Ferizaj.Në parcelën .. ZK Ferizaj nuk ka të ndërtuar ndonjë objekt, por është livadhë.

Parcela ...-5ZK Ferizaj me sipërfaqe 129 m² me kulturë arë e klasës 3 me sipërfaqe prej 97 m² dhe rrugë me sipërfaqe prej 32 m² është pronë private me pronar E.D.D. me pjesë të pronës 1/1.Pas daljes në terren dhe matjeve të bëra konstatohet se parcela ...-5 ZK Ferizaj kufizohet: Në anën veriore në gjatësi prej 5.24m kufizohet me rrugë publike; Në anën lindore në gjatësi prej 25.52m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj; Në anën jugore në gjatësi prej 5.10m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj dhe Në anën perendimore në gjatësi prej 26.07m kufizohet me parcelen ... ZK Ferizaj.Në parcelën ... ZK Ferizaj për të cilën është objekt kontesti nuk ka të ndërtuar ndonjë objekt, por është rrugë.

Parcela ... ZK Ferizaj me sipërfaqe 744 m² me kulturë arë e klasës 2 me sipërfaqe prej 542 m² dhe rrugë me sipërfaqe prej 202 m² është pronë private me pronar F.D. me pjesë të pronës 1/1. Pas daljes në terren dhe matjeve të bëra konstatohet se parcela ... ZK Ferizaj kufizohet: Në anën veriore në gjatësi prej 32.97m kufizohet me rrugë publike; Në anën lindore në gjatësi prej 31.65m kufizohet me parcelën .. ZK Ferizaj; Në anën jugore në gjatësi prej 46.50m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj dhe;Në anën perendimore në gjatësi prej 25.52m kufizohet me parcelën .. ZK Ferizaj.Në parcelën ... ZK Ferizaj për të cilën është objekt kontesti ka të ndërtuar një shtëpi P+2 dhe pjesa tjetër është oborr.

Parcela ... ZK Ferizaj me sipërfaqe 211 m² me kulturë arë e klasës 2 me sipërfaqe prej 158 m² dhe rrugë me sipërfaqe prej 53 m² është pronë private me pronar E.D.D. me pjesë të pronës 1/1. Pas daljes në terren dhe matjeve të bëra konstatohet se parcela ... ZK Ferizaj kufizohet: Në anën veriore në gjatësi prej 10.25m kufizohet me rrugë publike;Në anën lindore

në gjatësi prej 20.91m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj. Në anën jugore në gjatësi prej 9.98m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj dhe Në anën perendimore në gjatësi prej 21.98m kufizohet me parcelën .. ZK Ferizaj.Në parcelën ZK Ferizaj për të cilën është objekt kontesti nuk ka të ndërtuar ndonjë objekt, por është livadhë.

Me leximin e ekspertizës së dates 04.04.2023 dhe plotësimit të ekspertizës i datës 06.10.2023 dhe 09.04.2024 ,të hartuara nga ekspertja gjeodete F.B.L. dhe dëgjimin e të njejtës eksperte në séance gjyqësore gjykata ka vërtetuar:

Objekt kontesti është sipërfaqja prej prej m2 ,pjesë e ngastrës kadastrale ... ,me numër të propozuar nga eksperti gjeodet Zona Kadastrale në Ferizaj e cila sipërfaqe prej 2628 m2 ka këto kufijë dhe përmasa:në anën veriore në gjatësi prej 9.39 m kufizohet me pjesën e parcelës ... ZK Ferizaj.Në anën lindore në gjatësi prej 4.58 m kufizohet me parcelën ,në gjatësi prej 149.07 m kufizohet me parcelën ... ,në gjatësi prej 110.31 m ,kufizohet me parcelën ... dhe në gjatësi prej 43.46 m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj.Në anën jugore në gjatësi prej 8.10 m kufizohet me rrugën publike dhe në anën perëndimore në gjatësi prej m kufizohet me pjesën e parcelës ... ZK Ferizaj.Në sipërfaqen prej ... m2 ka të ndërtuara katër pjesë të shtëpive dhe pjesët tjera janë oborr.

Objekt kontesti është sipërfaqja prej... m2 ,pjesë e ngastrës kadastrale ... ,të cilës eksperti gjeodet ia ka propozuar numrin e ri kadastral .. ZK Ferizaj e cila sipërfaqe prej 1981 m2 ka këto kufijë dhe përmasa :Në anën veriore në gjatësi prej 21.64 m kufizohet me parcelën ... ,në gjatësi prej 4.01 m kufizohet me parcelën ... ,në gjatësi prej 16.03 m kufizohet me parcelën prej ... ,në gjatësi prej 16.08m kufizohet me parcelën ... dhe në gjatësi prej 4.01 kufizohet me parcelën prej... ZK Ferizaj .Në anën lindore në gjatësi prej 395.35 kufizohet me pjesën e parcelës ... ZK Ferizaj .Në anën jugore në gjatësi prej 8.40 kufizohet me rrugën publike dhe në anën perëndimore në gjatësi prej 435.38 m kufizohet me pjesën e parcelës ... dhe në gjatësi prej 1.08 m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj. Në sipërfaqen prej 1981 m2 nuk është i ndërtuar ndonjë objekt ,por është rrugë me zhavor.

Objekt kontesti është sipërfaqja prej 686 m2 ,pjesë e ngastrës kadastrale ... së cilës eksperti gjeodet ia ka propozuar numrin e ri .. ZK . cila sipërfaqe ka këto kufijë dhe përmasa:Në anën veriore në gjatësi prej 8.03m kufizohet me pjesën e parcelës ... ZK Ferizaj;Në anën lindore në gjatësi prej 73.32m kufizohet me parcelën ... dhe në gjatësi prej

9.42m kufizohet me parcelën .. ZK Ferizaj- Në anën jugore në gjatësi prej 9.39m kufizohet me pjesën e parcelës ... ZK Ferizaj dhe në anën perendimore në gjatësi prej 79.59m kufizohet me pjesën e parcelës ... ZK Ferizaj.Në pjesën e parcelës ... ZK Ferizaj për të cilën është propozuar numri i ri kadastral .. për të cilën është objekt kontesti ka të ndërtuar një pjesë e shtëpisë P+1 në pjesën veriore dhe pjesa tjetër është oborr.

Objekt kontesti është sipërfaqja prej m2 ,pjesë e ngastrës kadastrale së cilës eksperti gjeodet ia ka propozuar numrin e ri ... ZK Ferizaj dhe këto kufi dhe përmasa :Në anën veriore në gjatësi prej 20.00m kufizohet me pjesën e parcelësZK Ferizaj;Në anën lindore në gjatësi prej 47.25m kufizohet me pjesën e parcelës .. ZK Ferizaj;në anën jugore në gjatësi prej 15.65m kufizohet me rrugë publike dhe në anën perendimore në gjatësi prej 45.19 m kufizohet me pjesën e parcelës ... ZK Ferizaj.Në pjesën e parcelës ZK Ferizaj për të cilën ja kam propozuar numrin e ri kadastral ... për të cilën është objekt kontesti nuk ka të ndërtuar ndonjë objekt, por është livadhë.

Objekt kontesti është sipërfaqja prej 500 m2 ,pjesë e ngastrës kadastrale ...-5 së cilës eksperti gjeodet i aka propozuar numrin ...-7 e cila sipërfaqe ka këto kufijë dhe përmasa :në anën veriore në gjatësi prej 10.42 m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj ,në anën lindore në gjatësi prej 38.82 m kufizohet me parcelën ... ZK Ferizaj,në anën jugore në gjatësi prej 16.71 m kufizohet me rrugën publike dhe në anën perëndimore në gjatësi prej 38.01 m kufizohet me pjesën e parcelës ...-5 ZK Ferizaj .Në sipërfaqen e sipër përmendur ka të ndërtuar një garazhë dhe pjesa tjetër është oborr.

Objekt kontesti është ngastra kadastrale ... me sipërfaqe prej ...m2 Zona Kadastrale në Ferizaj ,për të cilën nga certifikata pronësore e dates 24.01.2024 ,e lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale në Ferizaj vërtetohet se në regjistrin kadastraë evidentohet në emër të N.D. ,nga babai E.me numër personaldhe D.D. ,nga babai Q. ,me numër personal

Objekt kontesti është ngastra kadastrale me sipërfaqe prejm2 Zona Kadastrale në Ferizaj ,për të cilën nga certifikata pronësore e dates 24.01.2024 ,e lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale në Ferizaj vërtetohet se në regjistrin kadastralë evidentohet në emër të D.D. ,nga babai Q... ,me numër personal

Me leximin e historiatit për paluejtshmëritë kontestuese ,e dates 23.03.2023 ,me numër ,i lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale në Ferizaj i cili historiat është pjesë e ekspertizës së gjeodezisë gjykata ka vërtetuar:

Parcela Kadastrale ...-1 ZK Ferizaj në gjendjen fillestare ka qenë e evidentuar në emër të B..... K.M. , Z.B. K., M.S., B.K.M.B. me nga 1/3 pjesë ideale . Regjistrimi i ndërrimeve 55/2010 ,parcela kadastrale ...-1 ZK Ferizaj në gjendjen e vjetër evidentohet në emër të D.L. ,B.K. ,M.S. dhe B.K.M.B. me nga 1/3 pjesë ideale. Në gjendjen e re është regjistruar në emër të M.D. regjistrimi është bërë sipas aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj me nr.C.nr.... dhe aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut me nr.1424/2008.Numri protokollit AKK/.... parcela kadastrale ... ZK Ferizaj është bërë modifikimi i sipërfaqes nga ... m2 në 2341 m2.Numri i protokollit 09/.../ND ,parcela kadastrale ZK Ferizaj është ndarë dhe janë krijuar parcelat kadastrale me nr.... dhe ZK Ferizaj .Regjistrimi i ndërrimeve parcelat kadastrale ZK Ferizaj në gjendjen e vjetër evidentoheshin në emër të M.D. ,kurse në gjendjen e re në emër të Z.D. parcela kadastrale ,në emër të Z.D. dhe D.D. me nga ½ pjesë ideale parcela Kadastrale .. dhe D.D. parcela kadastrale ... regjistrimi është bërë në bazë të aktvendimit për trashëgimin LRP.nr..... dhe Ref.nr.... noter Selatin Shahini.

Nga gjendja faktike e sipër përmendur sa i përket historiatit për parcelën ... rezulton se pjesa e sajë prej ...m2 e modifikuar ... m2 është gjykuar me aktgjykimin të Gjykatës Komunale në Ferizaj me nr.C.nr....,sepse në bazë të këtij aktgjykimi është bërë edhe regjistrimi i pronësisë për njësinë kadastrale ... ZK Ferizaj në regjistrin kadastral në emër të M.D. edhe atë me sipërfaqe të njejtë siq është vërtetuar me aktgjykimin në fjalë 2306 m2 e cila më vonë është modifikuar në sipërfaqe prej ... m2.Kurse pas ndarjes së të njejtës ngastër në mesin e ngastrave të krijuara është edhe ngastra kadastrale ...-5,kurse nga kjo ngastër paditësi kërkon 500 m2 me numër ë propozuar ...-7 e që nga kjo gjendje faktike rezulton se kontesti sa i përket sipërfaqes në fjalë është qështje e gjykuar me aktgjykimin të Gjykatës Komunale në Ferizaj me nr.C.nr...Kurse pjesen refuzuese te aktgjykimit C.nr.445/2005 rezulton se paditesit A.D. iu kishte refuzuar kërkesëpadi edhe për 1/3 pjesë ideale të parcelës ... ZK Ferizaj .

Mandje nga fleta e vjetër poseduese për njësin kadastrale ZK Ferizaj rezulton se kjo ngastër kishte sipërfaqe të tërsishme 2534 m2 ,ku nga kjo për sipërfaqen prej 2306 m2 iu

kishte njohur e drejta e pronësisë M.D. ,kurse në sipërfaqen prej 228 iu kishte njohur e drejta e pronësisë A.D.

Parcela kadastrale ZK Ferizaj në gjendjen fillestare ka qenë e evidentuar në emër të B.K.M.Z. ,, B.K.M.Z dhe B.K.M.B me nga 1/3 pjesë ideale.Në gjendjen e re është regjistruar në emër të N.D. regjistrimi është bërë sipas Kontratës për Shitblerjen e Paluejtshmërisë nr.71.../11 ,e dates 12.09.2011 e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Ferizaj .Regjistrimi i ndërrimeve ... parcela kadastrale ..1 ZK Ferizaj në gjendjen e vjetër evidentohej në emër të N.D. kurse në gjendjen e re në emër të N.D. 9/13 pjesë ideale dhe T.D. 4/13 pjesë ideale ,i cili regjistrim është bërë në bazë të kontratës për dhuratën LRP.nr..... dhe Ref.nr.1016/2015. Regjistrimi i ndërrimeve ... parcela kadastrale ... ZK Ferizaj në gjendjen e vjetër evidentohej në emër të N.D. 9/13 pjesë ideale dhe T.D./13 pjesë ideale ,kurse në gjendjen e re në emër të Nikoll demaj 7/13 pjesë ideale,T.D. me 4/13 pjesë ideale dhe D.D. me 2/13 pjesë ideale i cili regjistrim është bërë në bazë të kontratës për dhuratën LRP.nr.2.../2015 dhe Ref.nr.... noteri G.H.

Me leximin e aktgjykimit C.nr.205/06 ,i dates 18.12.2013 ,gjykata ka vërtetuar se me të njejtin aktgjykim ishte aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.D.,kundër të paditurit E.D. dhe ishte vërtetuar se paditësi A.D. është pronarë i ngastrave ... me sipërfaqe prej.... m2 dhe ... me sipërfaqe të përgjithshme prej m2 ZK Ferizaj .Por nga përmbajtja e të njejtit aktgjykim nuk rezulton të jetë i plotëfuqieshëm dhe nuk ka prove se është ekzekutuar në regjistrin kadastral.

Me leximin e procesverbalit mbi séances kryesore ,i dates 16.03.2011 ,me numër E.nr.... ,gjykata ka vërtetuar se Gjykata Komunale në Ferizaj kishte lejuar masen e përkohshme me date 21.11.2005 dhe në të njejtën séance paditësi A.D. kishte theksuar se E. D.D. nuk e kanë reaspektuar masën e përkohshme duke ndërtuar shtëpitë në ngastrat kontestuese e që nga ky procesverbal rezulton se kur flitej për ngastrat kontestuese ishte fjala për ngastrat e gjykuara me aktgjykimete e sipër përmendura.

Me leximin e propozimit për përmbarrim ,i dates 07.11.2013 ,gjykata ka vërtetuar se ishte caktuar përmbarrimi në bazë të propozimit të propozuesit A.D. me të cilin ishin urdhëruar Q.D. dhe E.D. që në lidhje me ngastrat ... dhe 1... ZK Ferizaj të mos ndërmarrin kurrfarë ndërtimi të objekteve ndërtimore deri në zgjidhjen definitive të kontestit në lëndën C.nr.445/05.

Me leximin e Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj, me numër Nd.nr ... i datës 23.01.2012, gjykata ka vërtetuar se ishte bërë rivendosja e pikave kufitare të ngastrave kadastrale nr.... të cilën e shfrytëzonin propozuesit Z.D. dhe D.D. me ngastren kadastrale nr.... pronë e kundërpropozuesit E.D. e në shfrytëzim të kundërpropozuesit A.D..Po ashtu ishte bërë rivendosja e pikave kufitare të ngastrës kadastrale nr.... të cilën e shfrytëzonin propozuesit Z.D. dhe D.D. me ngastren kadastrale nr...., pronë e ku ndërpropozuesit E.D.e në shfrytëzim të kundërpropozuesit A.D. Rivendosja pikave kufitare ishte bërë me 15 shtylla metalike [me gjatësi 1 metër]përgjatë tërë gjatësisë në mes të ngastrës kadastrale ,në bazë të gjendjes së shënimeve të ndarjes fizike dhe kordinata detale ashtu është definuar me skicën e ekspertit të gjeodezisë Q.H. ,e dates 18.11.2011 dhe raportet pjesë e aktvendimit.

Me lëximën e fletëposedimit për gjendjen e viteve i lëshuara nga ZKK Ferizaj në vitin 2017 Rezulton se ngastra kadastrale.. ZK Ferizaj kishte sipërfaqe 1892 m2 arë,500 m2 oborr dhe 142 m2 shtëpi ndërtesë.Kurse ngastra kadastrale . kishte sipërfaqe prej .. m2 ZK Ferizaj.

Me leximin e aktvendimit të dates 11.03.1983 T.nr..... ,i Gjykatës Komunale në Ferizaj ,gjykata ka vërtetuar se me të njëjtin aktvendim ishte shqyrtuar pasuria trashëgimore e të ndjerit I.D. ,nga babai D. ,ish nga F. i cili kishte lindur në vitin 1937 ,kurse kishte vdekur në vitin 19.09.1967 e cila pasuri përbëhej nga parcela kadastrale ... ,me sipërfaqe prej 620 m2 ZK Ferizaj ½ në emër të trashëgimlënësit ,parcela kadastrale ..me sipërfaqe prej 50,19 ha ZK Tankosiq ,parcela kadastrale ... me sipërfaqe 1,04 ari shtëpi ndërtesë dhe livadh 26,64 ari ,parcela kadastrale me sipërfaqe 02,20,84 ha të shënuara në fletën poseduese 3381.Trashëgimtar i pasurisë së përmendur ishte shpallur E.D. .Kurse nuk ishin shpallur trashëgimtar vëllezërit Q.D., A.D.,motrat D.B.ngaV.Xh. nga Fshatin B.J,M. nga B...,Xh.M. nga FshatiS...D.A. nga Sh.me arsyetim se nuk i pranojnë pjesët e pasurisë ,kurse A.D. nga pjesa e tij kishte hjekur dorë në dobi të vëllaut E.D..Kurse nga përmbajtja e të njëjtit aktvendim rezulton se është i plotëfuqieshëm nga data 11.03.1983.

Kurse nga leximi i procesverbalit T.nr..... ,i dates 18.02.1983 rezulton se E.D. nuk e kishte pranuar pasurinë që i takon sipas ligjit ,por nga aktvendimi i dates 11.03.1983 rezulton se se E.D. i ka pranuar pjesët nëse ndonjëri nga trashëgimtarët hjek dorë në dobi të tijë.

Gjykata pasi që vlerësoi provat e administruara, deklaratat e palëve ndrgjyqëse ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi edhe atë nga këto arsye:

Gjykata e ka refuzuar si të pa bazuar pjesa e kërkesëpadisë së paditësit A.D. ,me të cilën ka kërkuar që të anulohen :

Kontrata me nr..... e vërtetuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj, me datë 12.09.2011, sepse pala paditëse me asnjë provë nuk ka vërtetuar, se kontrata nr. e vërtetuar në Gjykatën komunale në Ferizaj më datë 12.09.2011 është e pa vlefshme. Nga përmbajtja e të njejtës kontratë rezulton se është lidhur në formën e parapar me Ligjin për Qarkullimin e Pronës së Paluajtshme ,sepse nënshkrimet e palëve janë vërtetuar nga Gjykata Komunale në Ferizaj. Faktin se D.LL. në kohën e lidhjes së kësaj kontrate kishte deklaruar se shitblerja e paluajtshmërisë objekt i kontratës kishte ndodhur në vitin 1973 ,kur D.Ll. nuk ishte i gjallë-nuk kishte lindur nuk e bënë këtë Kontratë të pa vlefshme ,sepse nga gjendja faktike e vërtetuar, dhe e sqaruar si më lartë rezulton se tani D.Ll., deklaratën në fjalë e kishte dhënë në emër të nënës së tij të ndjerë Z.B. e cila ishte pronare formale e paluajtshmërive objekt i kontratës, por në ndërkohë kishte vdekur dhe pas vdekjes së saj, është fare e logjikshme se është rregulluar trashëgimia dhe mbi bazën e trashëgimisë paluajtshmëria objekt i kontratës ka kaluar në emër të pasardhësit të sajë, tani të paditurit D.L.Kjo gjendje faktike vërtetohet edhe nga historiat i paluajtshmërisë kontestuese, ku rezulton se ngastra kadastrale ... ishte e evidentuar në emër të tre bashkëpronarve , në mesin e të cilëve ishte edhe Z.B. dhe më vonë si bashkëpronar në vend të të njejtës ishte paraqitur D.LL. edhe pse në historiat është bërë një gabim por meqë kontratën e ka lidhur D.Ll., atëher bartja formale e pronësisë, nuk është bërë nga Z.L. në N.D., por nga D.Ll.. Sepse në të njejtin historiat shënon se bartja në emër të N.D. është bërë mbi bazën e Kontratës kontestuese, ...11 palë e së cilën nuk ka qenë Z.B., por ka qenë D.Ll. si djalë i saj.

Kurse me leximin e certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluejtshme ,e dates 07.03.2016 ,e lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale në Ferizaj ,gjykata ka vërtetuar për parcelën kadastrale me numër Zona Kadastrale në Ferizaj ishin bërë ndrrime kadastrale, edhe në bazë të aktvendimit të trashëgimisë T.nr.... ,i dates 04.07.2006 ,i Gjykatës Komunale në N... që kjo jep me kuptuar se deklarata e avokatit Miftar Islami, në emër të B.B. e shënuar në Kontratë edhe si B.B. kur thekson se D.Ll., nuk ka qen pjesëmarrës i shitblerjes por ka qenë nëna e tij, Z. kurse i njejtë është paraqitur vetëm si trashëgimtar i nënës së tij.

Nga gjendja faktike e sipër përmendur por edhe nga Kontrata kontrestuese e vitit 12.09.2011, rezulton se palët kontraktuese e kësaj kontrate vetëm e kanë legalizuar në

aspektin ligjor një shitblerje e cila kishte ndodhur në mes palëve të kësaj kontrate në vitin 1973, me qëllim që të bëhej e mundur blerësit të paluajtshmërisë objekt kontrate që paluajtshmërinë objekt kontrate në Regjistrin kadastral ta regjistroj në emrin e tij, ku palët në këtë kontratë kishin deklaruar se shitblerja kishte ndodhur në vitin ... dhe ishte paguar çmimi i shitblerjes i deklaruar në euro, 5650€ duke bërë krahasimet me dinarët. Prandaj nuk mund të thuhet se kontrata në fjalë është fiktive, sepse edhe nëse nuk kishte kompensim për të njejtën kontratë atëher do të kishim të bëjmë me një kontratë mbi faljen e cila është e pranueshme nga ligji, por në rastin konkret bëhet fjalë, për legalizimin e një transankcioni juridik i cili nuk ishte lidhur në formën e parapar me ligj, e më vonë është legalizuar.

Përveq kësaj mosha e të paditurve tjerë S.V. dhe B.B. në vitin nuk ka qenë penges juridike që të njejtit të jenë pjesëmarrës të ndonjë raporti juridik civil, sepse nëse një person është i mitur veprimet në emrin e tij i merr përfaqësuesi ligjorë siq është prindi, sepse zotesia juridike e një personi fitohet me lindje dhe përfundon me vdekjen e personit.

Gjykata e ka refuzuar si të pa bazuar pjesën e kërkesë padisë së paditësit A.D. me të cilën ka kërkuar anulimin e kontratës me numër Ve..... e vërtetuar në Gjykatën Komunale të Beogradit me datë 29.06.2006, kontratës me numër vërtetuar në Gjykatën Komunale të Novi Sadit, me datë 03.10.2006, Kontratës (deklarata) Ve.nr.....të B.B., S.V., e të D.Ll., e vërtetuar pranë Gjykatës së parë Komunale në me datë 04.08.2006, sepse paditësi me asnjë provë nuk ka vërtetuar se këto kontrata janë të pa vlefshme. Madje i njejtë as që e ka prezantuar si provë këtë kontrata, dhe as nuk sqaron se për qfarë arsye e konteston vlefshmërinë e tyre e nuk vërteton as ekzistencën e tyre.

Gjykata e ka hedhur poshtë si e pa lejuar pjesë e padisë së paditësit A.D. me të cilën ka kërkuar, që sipërfaqja prej 2628 m/2, pjesë e ngastrës kadastrale ... , me numër të propozuar nga eksperti gjeodet ... ZK Ferizaj, të regjistrohet në emër të paditësit A. D., në librin kadastral me qëllim që të bëhet bartja te pronarit faktik edhe atë nga këto arsye: Me leximin e aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Ferizajit, C.nr. 445/05 rezulton se padia – kërkesë padia në fjalë është qështje e gjykuar, qështja e pronësisë sa i përket sipërfaqës ...m/2 pjesë e ngastrës kadastrale ... ZK Ferizaj, ka qenë objekt kontesti në qështjen kontestimore C.nr.445/05 e qështje është gjykuar me vendim të plotëfuqieshëm gjyqësorë siq vërtetohet nga dispozitivi pika 1, e aktgjykimit në fjalë dhe nuk mund të ketë gjykim dy herë për të njejtën çështje. Kurse fakti se ka identitet të paluajtshmërive në aktgjykimin në fjalë

sa i përket sipërfaqes 2628 m/2 dhe sipërfaqes që e kërkon paditësi me kërkesë padi ..m2 vërtetohet edhe nga ekspertiza e gjeodezisë. Përveq kësaj kjo pjesë e kërkesë padisë është e pa lejuar edhe nga fakti se gjykata nuk është organ kompetent që merret me regjistrimin e paluajtshmërive, por kjo është kompetencën ekskluzive e organit administrativ, në këtë Zyrës Kadastrale Komunale në Ferizaj, në të cilën zyrë paditësi ka mundur të parashtrij kërkesë që të zbatohet aktgjykimi i dt. 10.09.2008 me numër C.nr. 445/05 por për rrethanat e pa sqaruara nga paditësi nuk rezulton se se ai ka kërkuar regjistrimin e paluajtshmërisë së njohur me këtë aktgjykim në pikpamje të pronësisë, për sipërfaqën prej ... m/2 dhe në vend se ti drejtohet Zyrës Kadastrale i është drejtuar Gjykatës.

Gjykata ka Hedhur poshtë si e pa lejuar, pjesën e padisë e paditësit A.D. me të cilën ka kërkuar, që sipërfaqja prej .. m/2, pjesë e ngastrës kadastrale ... me numër të propozuar nga eksperti gjeodet 00 ZK Ferizaj, të regjistrohet në emër të paditësit A.D. në Drejtorinë për Urbanizëm , Kadastër , sepse edhe qështja kontestimore sa i përket paluajtshmërisë në fjalë është qështje e gjykuar me aktgjykimin C.nr. 445/05 i dt. 10.09.2008, sepse në paragrafin II këtij aktgjykimi rezulton se paditësit A.D. i është refuzuar kërkesë padia me të cilën kishte kërkuar që ti vërtetohet e drejta e bashkëpronësisë për 1/3 pjesë ideale të njësisë kadastrale ..., e që 1/3 pjesë ideale e njësisë në fjalë, nënkupton sipërfaqen ..m/2 që nënkupton se kjo sipërfaqe është më e madhe se sipërfaqja që paditësi e kërkon me kërkesë padi prej 2014 m2. Që identiteti objektiv i kërkesave të paditësit nga ajo që është gjykuar me aktgjykimin në fjalë dhe nga kjo që kërkohet tani me kërkesëpadi, rezulton se se kemi të bëjmë me të njejtën paluajtshmëri pa marrë para sysh faktin a është kërkuar si pronësi apo si bashkëpronësi, sepse edhe bashkëpronësia ekziston në ato raste kur disa persona kanë të drejtën e pronësisë mbi një send., ku pjesët e tyre dihen por nëse nuk dihen konsiderohen se janë të barabarta. Pra ky i fundit është një supozim ligjor juridik.Pra kemi të bëjmë me kërkesa të njejtja, sepse kemi të bëjmë me qështjen e pronësisë, pa marrë para sysh a emërtohet si pronësi apo si bashkëpronësi, por thelbi i kërkesave është i njejtë, sepse ka të bëjë me të njejtën pronë, ngastrën kadastrale ... Kurse gjykata e ka refuzuar pjesën e kërkesë padisë, së paditësit me të cilën ka kërkuar që për paluajtshmërinë në fjalë të kompensoj njësoj si ndaj fqit., sepse kjo kërkesë nuk arsyetohet në pikpamje të bazës së saj, duke mos sqaruar as për qfar kompensimi është fjala.

Gjykata ka hedhur poshtë si të pa lejuar pjesën e padisë së paditësit A.D., me të cilën ka kërkuar, që sipërfaqja prej ... m/2 pjesë e ngastrës kadastrale ..., me numër të

proponuar nga eksperti gjeodet ... ti bashkohet parcelës me numër ... me sipërfaqe prej 46396 m² bashkë me të 50% ti takoj paditësit A.D., 50% të paditurit - përfaqësuesit K.D. , sepse edhe qështja kontestimore sa i përket sipërfaqës prej 686 m² është qështje e gjykuar me aktgjykimin C.nr. i dt. 10.09.2008, sepse në paragrafin dy këtij aktgjykimi rezulton se paditësit A.D. i është refuzuar kërkesë padia me të cilën kishte kërkuar që ti vërtetohet e drejta e bashkëpronësisë për 1/3 pjesë ideale të njësisë kadastrale ... e që 1/3 pjesë ideale e njësisë në fjalë, nënkupton sipërfaqen 8470 m² që nënkupton se kjo sipërfaqe është më e madhe se sipërfaqja që paditësi e kërkon me kërkesë padi. Që identiteti objektiv i kërkesave të paditësit në atë të gjykuar sipas aktgjykimit C.nr. .. i dt. 10.09.2008 dhe tani që kërkon me kërkesëpadi , rezulton se se kemi të bëjmë me të njejtën paluajtshmëri pa marrë para sysh faktin a është kërkuar si pronësi apo si bashkëpronësi. , sepse edhe bashkëpronësia ekziston në ato raste kur disa persona kanë të drejtën e pronësisë mbi një send., ku pjesët e tyre dihet por nëse nuk dihen konsiderohen se janë të barabarta. Pra ky i fundit është një supozim ligjor juridik. Pra kemi të bëjmë me kërkesa të njejtë, sepse kemi të bëjmë me qështjen e pronësisë, pa marrë para sysh a emërtohet si pronësi apo si bashkëpronësi, por thelbi i kërkesave është i njejtë, sepse ka të bëjë me të njejtën pronë, ngastrën kadastrale 119-1. Përveq kësaj bashkimi i parcelave kadastrale nuk është kompetencë e gjykatës, por është kompetencë e Organit administrativ Zyres Kadastrale Komunale në këtë rast në Ferizaj . Kurse gjykata vendos vetëm mbi të drejtën e sendit të paluajtshëm siq është e drejta e pronësisë.

Gjykata ka Hedheur poshtë si të pa lejuar, pjesën e padisë së paditësit A.D.e të cilën ka kërkuar, që të regjistrohet në emër të paditësit A.D. sipërfaqja prej 900 m² pjesë e ngastrës kadastrale ... me numër të propozuar nga eksperti gjeodet ... dhe ti bashkohet parcelës .. me sipërfaqe prej 2014 +900 = 2914m² sepse edhe qështja kontestimore sa i përket sipërfaqes prej 900 m² është qështje e gjykuar me aktgjykimin C.nr. 445/05 i dt. 10.09.2008, sepse në paragrafin dy këtij aktgjykimi rezulton se paditësit A.D.i është refuzuar kërkesë padia me të cilën kishte kërkuar që ti vërtetohet e drejta e pronësisë për 1/3 pjesë ideale të njësisë kadastrale ..., e që 1/3 pjesë ideale e njësisë në fjalë, nënkupton sipërfaqen 8470 m² që nënkupton se kjo sipërfaqe është më e madhe se sipërfaqja që paditësi e kërkon me kërkesë padi. Që identiteti objektiv i kërkesave të paditësit, rezulton se se kemi të bëjmë me të njejtën paluajtshmëri pa marrë para sysh faktin a është kërkuar si pronësi apo si bashkëpronësi. , sepse edhe bashkëpronësia ekziston në ato raste kur disa

persona kanë të drejtën e pronësisë mbi një send, ku pjesët e tyre dihen, por nëse nuk dihen konsiderohen se janë të barabarta. Pra ky i fundit është një supozim ligjor juridik. Pra kemi të bëjmë me kërkesa të njejta, sepse kemi të bëjmë me çështjen e pronësisë, pa marrë para sysh a emërtohet si pronësi apo si bashkëpronësi, por thelbi i kërkesave është i njejtë, sepse ka të bëjë me të njejtën pronë, ngastrën kadastrale Përveq kësaj regjistrimi i pronësisë nuk është kompetencë e Gjykatës, por është kompetencë e organit administrativ në këtë rast Zyrës Kadastrale Komunale në Ferizaj .Kurse është refuzuar si e pa bazuar, pjesa e kërkesë padisë së paditësit A.D. me të cilën ka kërkuar, që të të kompensohet si ndaj fqiut,sepse nuk është vërtetuar baza juridike e kësaj pjese të kërkesëpadisë.

Gjykata e ka Hedhur poshtë si e pa lejuar, pjesa e padisë së paditësit A.D. me të cilën ka kërkuar, që sipërfaqja prej 500 m² pjesë e ngastrës kadastrale ...-5 me numër të propozuar nga eksperti gjeodet ...-7 ZK Ferizaj, të bartet në emër të paditësit A.D. Sepse me leximin e aktgjykimit C. Nr. 445/05 i dt. 10.09.2008 është vërtetuar se çështja sa i përket sipërfaqes së përmendur është qështje e gjykuar me këtë aktgjykim dhe nuk mund të gjykohet dy herë për të njejtën qështje.

Nga gjendja faktike e sipër përmendur sa i përket historiatit për parcelën ... rezulton se pjesa e sajë prej.. m² e modifikuar 2341 m² është gjykuar me aktgjykimin të Gjykatës Komunale në Ferizaj me nr.C.nr.445/2005,sepse në bazë të këtij aktgjykimi është bërë edhe regjistrimi i pronësisë për njësinë kadastrale ...-1 ZK Ferizaj në regjistrin kadastral në emër të M.D.edhe atë me sipërfaqe të njejtë siq është vërtetuar me aktgjykimin në fjalë 2306 m² e cila më vonë është modifikuar në sipërfaqe prej 2341 m².Kurse pas ndarjes së të njejtës ngastër në mesin e ngastrave të krijuara është edhe ngastra kadastrale ...-5,kurse nga kjo ngastër paditësi kërkon 500 m² me numër të propozuar ...-7 e që nga kjo gjendje faktike rezulton se kontesti sa i përket sipërfaqes në fjalë është qështje e gjykuar me aktgjykimin të Gjykatës Komunale në Ferizaj me nr.C.nr.445/2005.Kurse pjesen refuzuese te aktgjykimit C.nr.445/2005 rezulton se paditesit A.D. iu kishte refuzuar kërkesëpadi edhe për 1/3 pjesë ideale të parcelës ... ZK Ferizaj .Gjykata e ka hedhur poshtë si të pa lejuar pjesën e padisë së paditësit A.D. me të cilën ka kërkuar, që parcela kadastrale ..., me sipërfaqe prej 620 m² të regjistrohet në emër të paditësit A.D. sepse regjistrimi i së drejtës së pronësisë nuk është kompetencë e gjykatës, por kompetencë e Organit aadministrativ, - Zyrës Kadastrale Komunale në Ferizaj madje paditësi me asnjë provë nuk ka vërtetuar, se është pronar i paluajtshmërisë në fjalë. Kurse

nga aktvendimi për trashëgiminë T. Nr. 40/83 i dt. 11.03.1983 rezulton se paditësi A.D. ka hequr dorë nga trashëgimia, për të njejtën ngastër, duke ia ceduar vëllaut të tij E.D.

Gjyka ka Hedhur poshtë si të pa lejuar, pjesën e padisë së paditësit A.D. me të cilën ka kërkuar që parcela kadastrale me sipërfaqe prej 1031 m/2 të korrigojohet dhe të regjistrohet në librin kadastral në emër të paditësit A.D., sepse regjistrimi në regjistrin kadastral si dhe korrigjimet eventuale nuk janë kompetencë e gjykatës por janë kompetencë e Organit administrativ, - Zyrës kadastrale Komunale.

Kompetenca e Zyrës Kadastrale Komunale dhe më pas e Agjencionit Kadastral të Kosovës si organ i shkallës së dytë për të vendosur në lidhje me Kërkesat për regjistrimin e të drejtave të pronave të paluajtshme dhe korrigjimet eventuale në regjistrin e paluejtshmërive është paraparë me Ligjin nr. 2002/ 5 Për Themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së Paluejtshme, ligj ky i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.2003/13 i dates 01.08.2008 dhe Ligjin nr.04/L-009,të dyja këto ligje per ndryshimin dhe plotësimin e Ligjin nr. 2002/ 5 Për Themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së Paluejtshme.

Kompetenca e Zyrës Kadastrale Komunale dhe më pas e Agjencionit Kadastral të Kosovës si organ i shkallës së dytë për të vendosur në lidhje me korrigjimet në regjistrin kadastral është paraparë edhe me nenin 17 të Ligjit për Kadastër nr.04/-L-013 i dates 01.09.2011 dhe vetëm nëse gabimet nuk mund të korrigojohen në procedure administrative mund të adresohen në gjykatë dhe paditësi me asnjë prove nuk ka vërtetuar se ka kërkuar korrjimin e gabimit në procedure administrative dhe se ky gabim nuk ka mundur të korigjohet në procedure administrative.Por në rastin konkret paditësi nuk tregon se a kemi të bëjmë me gabim material apo gabim teknik dhe për qfarë gabimi është fjala.

Kurse me nenin 18 paragrafi 2 të LPK-së është paraparë kur gjykata gjatë procedimit të çështjes konstaton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente gjykata veçse ndonjë organ shtetëror tjetër, do të shpallet inkompetente, do t'i shpallë të pavlefshme të gjitha veprimet procedurale te kryera dhe do ta hedhë poshtë padinë që i është paraqitur.

Kurse e drejta e gjykatës për ta hedhur poshtë padin kur kemi të bëjmë me çështje të gjykuar është paraparë me nenin 166.2 të LPK-së me të cilën dispozitë është paraparë “Gjykata gjatë gjithë procedimit të çështjes kujdeset sipas detyrës zyrtare se a mos është gjë e

gjykuar çështja e ngritur me padi dhe nëse konstaton se procedura është iniciuar për kërkesën për të cilën ekziston vendimi i formës së prerë, padia duhet të hedhet poshtë si e palejueshme.

Kurse mundësia e anulimit të kontratave është paraparë me nenin 103 të LMD-së së RSFJ të vitit 1978 me të cilën dispozitë ishte paraparë Kontrata që është në kundërshtim me parimet e përcaktuara me kushtetutë të rregullimit shoqëror me dispozitat e detyrueshme apo me moralin e shoqërisë është nul, në qoftë se qëllimi i rregullës së shkelur nuk pasjell ndonjë sanksion tjetër apo në qoftë se ligji në rastin e caktuar nuk parashikon diçka tjetër.

Kurse në rastin konkret me prova nuk është vërtetuar se kontratat anulimin e të cilave kërkon paditësi janë të pavlefshme gjegjësisht janë në kundërshtim me dispozitat e sipër përmendura ligjore, të cilat kanë qenë në fuqi kur janë lidhur kontratat anulimi i të cilave kërkohet.

Kurse pjesës së ekspertizës së gjeodezisë kur theksohet se pjesët tjera të ngastrës kadastrale 119-1 nuk janë qështje të gjykuara ,me përjashtim të sipërfaqes prej 2628 m2 gjykata nuk ia fali besimin ,sepse nga gjendje faktike e vërtetuar gjegjësishtë aktgjykimi C.nr.445/05 rezulton se të gjitha pjesët e kërkesëpadisë që kanë të bëjnë me ngastrën 119-1 dhe ...-5 paraqesin qështje të gjykuara.

Vendimi sa i përket masës së sigurisë së përkohshme është marrur duke u bazuar në nenin 297 të LPK-së sepse paditësi nuk e ka bërë të besueshme të drejtën subjektive, siq është vërtetuar në procedurë sipas këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës ,sepse paditësi e ka humbur kontestin gjyqësorë ,kurse të paditurin nuk kanë parashtruar kërkesë të specifikuar sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Gjyqtari

Burim Emërllahu

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh duke llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit, nëpërmes kësaj gjykate.